



Strazbur/Varshavë, 5 gusht 2009

CDL-AD(2009)032

Opinion Nr. 509 / 2008

Originali Anglisht

KOMISIONI EVROPIAN PËR DEMOKRACI PËRMES LIGJIT
(KOMISIONI I VENEDIKUT)

OPINION I PËRBASHKËT

MBI KODIN ZGJEDHOR
të “ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”
pas përmirësimeve të 29 tetorit 2008

nga Komisioni i Venedikut
dhe
Zyra e OSBE-së për institucione demokratike
dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR)

E aprovuar nga Këshilli për zgjedhje demokratike
në mbledhjen e 29^{të} (Venedik, 11 qershor 2009)

dhe nga Komisioni i Venedikut
në seancën plenare të 79^{të} (Venedik, 12-13 qershor 2009)

në bazë të komenteve nga:

Z. Oliver KASK (Anëtar i Komisionit të Venedikut, Estoni)
Zsh. Maria Teresa MAURO (Eksperte e Komisionit të Venedikut, Itali)
Z. Kåre VOLLAN (Ekspert i Komisionit të Venedikut, Norvegji)
Z. Victor ULLOM (Ekspert i OSBE/ODIHR-së)

A. Hyrje

1. Komisioni i Venedikut i Këshillit të Evropës dhe Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) e kanë shqyrtuar Kodin zgjedhor të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, pas ndryshimeve të muajit tetor 2008.

2. Opinioni aktual është elaboruar pas rezolutës 1320 (2003) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila kërkon nga Komisioni i Venedikut të formulojë opinione që kanë të bëjnë me përmirësimet e mundshme të legjislacionit dhe praktikave në shtete të vecanta anëtare ose shtete aplikante.

3. Amandamentet e fundit përfshijnë ndryshime në kriterin për daljen e votuesve në zgjedhjet presidenciale, votimit jashtë shtetit, regjistrimin e votuesve, financimin e fushatës si dhe procesin e ankesave dhe apeleve. Disa nga amandamentet janë bazuar mbi një draft tekst punues i cili ndryshon Kodin zgjedhor dhe që u shqyrtua nga Komisioni i Venedikut dhe OSBE/ODIHR-ja në vitin 2007 (CDL-AD(2007)012). Ky vlerësim aktual duhet të lexohet bashkë me këtë dokument dhe me Opinione të tjera të përbashkëta përkatëse (shih par.4).

Shumë komente në tekstet e mëparshme janë marrë parasyshtë megjithse të tjerë mbeten për t'u adresuar. Në këtë dokument nuk janë përfshirë të gjitha komentet.

4. Dokumenti aktual u miratua nga Këshilli për zgjedhje demokratike në mbledhjen e tij të 29të (Venedik, 11 qershor 2009) dhe nga Komisioni i Venedikut gjatë seancës së tij të 79të plenare (Venedik, 12-13 qershor 2009).

B. Dokumente referuese

5. Ky opinion bazohet në:

- Përkthimin jozyrtar të Kodit zgjedhor të shqyrtuar të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (sic është publikuar në gazetën zyrtare 40/2006, 136/2008, 148/2008 dhe 155/2008; CDL(2009)006).
- Opinioni e Komisionit të Venedikut mbi Kodin zgjedhor të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (CDL-AD(2008)036; 15 dhjetor 2008).
- Opinioni e përbashkët të Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ODIHR-së mbi projekt-tekstin punues i cili ndryshon Kodin zgjedhor të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (CDL-AD(2007)012; 21 mars 2007).
- Opinioni e përbashkët të Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ODIHR-së mbi projekt-tekstin punues i cili ndryshon Kodin zgjedhor të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (CDL-AD(2006)022; 10 korrik 2006).
- Opinioni e përbashkët të Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ODIHR-së mbi projekt-amendamentet e Kodit zgjedhor të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (CDL-AD(2006)008; 21 mars 2006).
- Kodin e praktikave të mira në çështjet zgjedhore – udhëzime dhe raport spjegues. Të miratuara nga Komisioni i Venedikut në seancën e tij të 52të (Venedik, 18-19 tetor 2002; CDL-AD (2002)023rev).
- Udhëzimet e OSBE/ODIHR-së mbi rishikimin e Kornizës ligjore për zgjedhjet, janar 2001.

- OSBE/ODIHR, Përkushtimet ekzistuese për zgjedhje demokratike në shtetet pjesëmarrëse në OSBE (Varshavë, tetor 2003).
- Raportin final të Misionit të OSBE/ODIHR-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 1 qershorit, 2008, në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.
- Deklaratën mbi rezultatet dhe konkluzionet preliminare për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale dhe komunale në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, 22 mars 2009.
- Deklaratën mbi rezultatet dhe konkluzionet preliminare për rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale dhe komunale në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, 5 prill 2009.
- Raportin final për zgjedhjet presidenciale dhe komunale të 22 marsit dhe 5 prillit në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.
- Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës mbi vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” (1 dhe 15 qershor 2008) (23 qershor 2008; Doc. 11647).
- Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës mbi vëzhgimin e zgjedhjeve presidenciale në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” (22 mars dhe 5 prill 2009) (27 prill 2009; Doc. 11866).

C. E drejta për të votuar dhe për t’u kandiduar në zgjedhje

6. **Neni 7(2)** parasheh ndalesën e të drejtës për t’u zgjedhur për ata qytetarë të cilët kanë qenë të dënuar me vendim përfundimtar të gjykatës me burgim të pakushtëzuar për së paku 6 muaj. Kjo është një ndalesë e përgjithshme; duhet të bëhet e qartë se dënimi për një akt penal, pasi të jetë mbajtur, nuk duhet të kufizojë ato të drejta fundamentale, siç është e drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, meqenëse nuk do të ishte në përputhshmëri me parimin e proporcionalitetit dhe në këtë mënyrë do të shkelte të drejtën e paraparë me Nenin 3 të Protokollit të Parë të ECHR dhe Nenit 7(5) të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së.¹

7. **Neni 6 dhe 7** nuk u lejon të huajve të votojnë ose të kandidohen në zgjedhje për këshillat komunalë dhe postet e kryetarëve të komunave. Rekomandohet që e drejta për të votuar dhe për t’u zgjedhur t’u jepet banorëve të huaj me qëndrim afatgjatë dhe që mes tjerash të jetë në përputhshmëri me Konventën e Këshillit të Evropës mbi pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal (Neni 6). Për këtë arsye rekomandohet që e drejta për të votuar në zgjedhje lokale t’u jepet pas një kohe të caktuar banimi në vend, zakonisht 5 vjet.²

Ç. Kriteri i daljes së votuesvë në zgjedhjet presidenciale

8. Në bazë të ndryshimeve të fundit të Kushtetutës, një kandidat zgjedhet për Kryetar shteti në rrethin e parë, nëse ai ose ajo merr shumicë absolute të votave nga numri i përgjithshëm i

¹ Shih Kodin e praktikave të mira në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut (CDL-AD(2002)023rev), I, 1.1 d.

² Shih Kodin e praktikave të mira në çështjet zgjedhore, I, 1.1 b. ii.

votuesve të regjistruar. Nëse jo, rrethi i dytë mbahet midis dy kandidatëve që udhëheqin me vota, dhe ai i cili merr më shumë vota zgjedhet Kryetar shteti, me kusht që më shumë se 40% e votuesve të regjistruar të hedhin fletëvotimin. Nëse dalja në rrethin e dytë është nën 40%, zgjedhjet duhet të përsëriten.

9. Pragu jashtëzakonisht i lartë për t'i fituar zgjedhjet në rrethin e parë (50% e votuesve të regjistruar) është ikje nga rregulli i rëndomtë prej më shumë se 50% të votave të vlefshme të hedhura në zgjedhje. Dispozita aktuale duket se është një kriter i fuqishëm pa nevojë, dhe mund të nënkuptojë që rrethi i dytë është i domosdoshëm edhe nëse një kandidat i mposhtë të gjithë kandidatët e tjerë me dallim të madh.³ Korniza ligjore mund të ndryshohej, për shembull duke përcaktuar se kandidati fiton në rrethin e parë nëse shumica e votuesve të regjistruar dalin në zgjedhje (ose madje 40%) dhe kandidati merr mbi 50% të votave të vlefshme. Kjo megjithatë, do të implikojë nevojën e ndryshimeve kushtetuese.

10. Siç u tha, kriteri për daljen e votuesve në zgjedhje për një rreth të dytë të vlefshëm në zgjedhjet presidenciale është ulur nga 50% në 40% me një amendament kushtetues. Rekomandimet e mëparshme sygjeronin që ky kriter për pragu të hiqet krejtësisht, meqenëse mund të shpiej në një sërë zgjedhjesh të dështuara. Në rast se pragu i daljes së votuesve llogaritet i dobishëm për besueshmërinë e procesit zgjedhor, ai rekomandohet vetëm për rrethin e parë.

11. Kodi duhet të parashohë rrethanat e tërheqjes së një kandidati nga zgjedhjet në kohën midis dy rrethëve të votimit, si për kryetarë komune ashtu edhe për kryetar shteti. Sipas të gjitha gjasave, së paku për zgjedhjet presidenciale, në përputhshmëri me nenin 81 të Kushtetutës, rrethi i dytë i zgjedhjeve do të vazhdonte dhe do të kërkohet nga kandidati i mbetur të marrë shumicën e detyrueshme. Kodi mund të qartësohej në këtë pikë, përfshi edhe për zgjedhjet lokale.

12. Gjithashtu, **Neni 121** i Kodit nuk e (ri)thekson dispozitën kushtetuese në lidhje me kriterin për dalje në rrethin e dytë. Kushtetuta thotë, “Kandidati zgjedhet për Kryetar shteti nëse ai/ajo fiton shumicën e votave të atyre që kanë dalë në votim, me kusht që mbi 40% e votuesve të regjistruar të kenë votuar”. Thënë nga aspekti ligjor nuk është e domosdoshme të përsëritet ajo që tashmë është në Kushtetutë, por për hirë të qartësisë do të ishte më mirë të theksoheshte rregulli përmbajtësor edhe në Kod. Në Kod, për të qenë më preciz duhet të theksohet se me “ata që kanë votuar” nënkuptohet “ata të cilët kanë hedhur fletëvotimin”, pra edhe fletëvotimet e pavlefshme.

D. Votimi jashtë shtetit dhe njësitë e reja zgjedhore

a. Marrëveshja për votimin jashtë shtetit

13. Që prej 1 shtatorit 2009, kur dispozitat e reja të Kodit do të hyjnë në fuqi, votuesit që janë përkohësisht jashtë shtetit do të kenë mundësi të regjistrohen për të votuar në zyrat diplomatike konsullare. **Neni 2** i Kodit i definon qytetarët që “përkohësisht janë jashtë shtetit” si qytetarë:

1. të cilët kanë regjistruar vendbanimin e tyre të fundit në Maqedoni, por të cilët në ditën e votimit gjenden përkohësisht jashtë vendit, me kusht që kjo periudhë të zgjasë nga tre muaj deri në një vit, ose

³ Me një dalje prej 58% në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009, një kandidat do të duhej të merrte 87% të votave për të fituar që në rrethin e parë. Edhe sikur dalja e votuesve të ishte më e lartë, të themi 70%, kandidati përsëri do të duhej të mbledhte mbi 71% të votave për të fituar që në rrethin e parë.

2. të cilët janë me qëndrim jashtë shtetit për më shumë se një vit dhe që janë regjistruar te autoritetet kompetente për qëndrim të përkohshëm jashtë vendit.

14. Në lidhje me këtë, shqetësimi nga një Opinion i Përbashkët⁴ i mëparshëm mbetet i rëndësishëm sepse do të dukej qartë se vetëm ata qytetarë të cilët kanë qëndruar jashtë shtetit për tre muaj deri në një vit, ose të cilët janë regjistruar si +përkohësisht jashtë shtetit, do të kishin të drejtën e votimit jashtë shtetit. Kjo mund të shihet si një pengesë arbitrare për të drejtën e votës për qytetarë të tjerë dhe duhet të rishqyrtohet.

15. Ngjashëm me këtë, mbetet shqetësimi edhe në lidhje me përbërjen e Këshillit zgjedhor (KZ) në zyrat diplomatike konsullare. Opinioni i Përbashkët i vitit 2007 vërejtë se,

“Sipas projekt-tekstit, Këshillat zgjedhorë për votim jashtë shtetit përbëhen nga nëpunës të Ministrisë së punëve të jashtme ... duhet të mërret parasysh edhe mundësia e këmbimit të stafit midis zyrave diplomatike dhe Ministrisë së punëve të jashtme, në mënyrë që anëtarët e këshillit të kenë më pak lidhje direkte me njëri tjetrin. Gjithashtu, anëtarët e Këshillit zgjedhor mund të rekrutohen nga radhët e qytetarëve që janë në dispozicion në shtetin përkatës, ose me rekomandim të partive kryesore, ose në bazë të secilit rast veç e veç.”⁵

b. Tri njësitë e reja

16. Sipas Kodit zgjedhor, votuesit jashtë shtetit formojnë tre elektorate të posaçme për zgjedhjet parlamentare: një i cili e mbulon Evropën dhe Afrikën, një për Amerikat, dhe një për Australinë dhe Azinë. Meqenëse nuk ka standard ligjor për masat e votimit jashtë shtetit dhe procedurat ndryshojnë dukshëm si nga gjerësia ashtu edhe nga qasja, zgjedhjet duhet në përgjithësi t'i plotësojnë të njëjtat standarde për zgjedhje demokratike si në procedurat brenda atij shteti. Duket se metoda e përshkruar në legjislacionin aktual nuk e arrin një standard të tillë dhe rekomandohet që të merret parasysh një formulë e re.

17. Së pari, Kodi siguron sistem proporcional për zgjedhjet parlamentare (me 6 njësi zgjedhore të një shkalle të lartë, me nga 20 vende deputetësh secila), por të tri njësitë në të cilat elektorati zgjedh vetëm nga një deputet dallohen nga ky parim, meqë një njësi që jep vetëm një mandat nuk mund të ndahet në mënyrë proporcionale.

18. Së dyti, duhet të ceket se përderisa njësitë vendore janë dizajnuar në mënyrë që të japin përafërsisht të njëjtin numër të votave për çdo vend deputeti, tri njësitë jashtë vendit janë paracaktuar secila me nga një vend deputeti pa marrë parasysh numrin e votuesve të regjistruar.

19. Prandaj, numri i votuesve që zgjedh secilin nga këto mandate sipas të gjitha gjasave do të dallojë në mënyrë të konsiderueshme midis veti, si dhe nga elektoratet brenda shteteve. Kjo rrezikon të kompromentojë parimin e të drejtës së barabartë për të votuar, dhe thënë më drejt, parimin e forcës së votimit të barabartë.⁶

⁴ Shih Opinioni i Përbashkët për projekt-tekstin punues për ndryshimin e Kodit zgjedhor të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (CDL-AD(2007)012, mars 2007).

⁵ Id.

⁶ Shih dokumentin e Kopenhagës, Neni 7.3 dhe shih Kodin e praktikave të mira në çështje zgjedhore, I, 2.2.

20. Përderisa krijimi i njësisë virtuale është një opion i mundshëm për votim jashtë shtetit, duke supozuar se një numër mjaft i madh i votuesve do të merrnin pjesë për të lejuar votim të barabartë, mandatet duhet të ndahen në një mënyrë e cila i mundëson sistemit proporcional të jetë efikas (në këtë rast duke pasur më shumë se një mandat të vetëm). Në mungesë të kësaj, rekomandohet që votat nga jashtë shtetit të numrohen në njësitë vendore të vendbanimit të fundit të votuesit.

c. Të tjera

21. Kërkesa në **Nenin 61** për mbledhjen e 200 nënshkrimeve të një kandidati për Parlament në një njësi jashtë shtetit duket se nuk është lidhur me shifrat e popullatës ose të numrit të votuesve të regjistruar, Siç është rasti me kërkesat për nënshkrime në vend. Kur numri i votuesve të regjistruar për të votuar në njësitë e sapokrijuara jashtë shtetit do të bëhet i ditur, mund të merret parasysh numri i nënshkrimeve të nevojshme si përqindje e (votuesve të regjistruar) popullatës.

22. Prania e vëzhguesve dhe përfaqësuesve të akredituar të partive politike ose kandidatëve janë elementet kyçe për transparencën e votës, dhe ata duhet të jenë poashtu të pranishëm gjatë votimit jashtë shtetit. Edhe pse asnjë tekst në Kod nuk nënkupton se ata nuk lejohen, mund të bëhet e qartë se ata janë të mirëseardhur, si dhe duhet të jepen indikacione për procedurën e akreditimit të tyre nga jashtë shtetit. Kjo posaçërisht është me rëndësi duke marrë parasysh veçantinë e përdorimit të Zyrave diplomatike konsullare si vendvotime.

Dh. Administrimi i zgjedhjeve

23. **Neni 23(1)** përcakton kuorumin për organet zgjedhore si dhe numrin e duhur për të marrë një vendim. Duhet pasur parasysh që një vendim i marrë të jetë i vlefshëm, shumica e “anëtarëve” mund të arrihet duke numëruar edhe zëvendësit, në rastet kur anëtari mungon. **Neni 23(2)** mund të qartësohet më tej duke shtuar “me të njëjtat të drejta për punë dhe votë si anëtari të cilin ai ose ajo e zëvendëson”.

24. Sipas **Nenit 27(5)** Kryetari dhe anëtarët e Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ) zgjedhen nga Parlamenti me dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të deputetëve në Parlament. Ndonëse kjo dispozitë kërkon konsensus të gjërë nga anëtarësia e KSHZ-së, kjo padyshim e bën më të vështirë emërimin e anëtarësisë, ndërsa procedura mund lehtë të prolongohet. Nënkuptohej që votimi në Parlament mbahet për secilin anëtarë veçmas. Megjithatë, dispozita do të përfitojë nga qartësimi.

25. **Neni 31(2)**: Në një Opinim të Përbashkët të mëhershëm mbi draftin e Kodit Zgjedhor⁷ ishte cekur se numri i detyrave të KSHZ-së dukej i tepruar. U sygjera që disa detyra mund të kalonin tek Komisionet komuanle zgjedhore (KKZ); për shembull, gjatë periudhës zgjedhore detyrat e mbikqyrjes duhet t’u lihen organeve të nivelit më të ulët (meqenëse detyrat gjatë ditës së zgjedhjeve marrin shumë kohë). Kodi zgjedhor tani përmban një gërshetim të detyrave në kontrollimin e KZ-ve⁸, dhe duhet të bëhet e qartë nëse KKZ-ja ose KSHZ-ja është organi përgjegjës për të kontrolluar punën e tyre.

⁷ CDL-AD(2006)008, paragrafi 17.

⁸ Neni 37(2) thotë që KKZ-të domosdoshmërisht “kontrollojnë” ligjshmërinë e punës së Këshillave zgjedhorë dhe intervenojnë në raste kur shkelja e ligjshmërisë është përcaktuar në ... “mbajtjen e zgjedhjeve”, përderisa Neni 32(2) i jep për detyrë KSHZ-së të “kontrollojë” vendvotimet në ditën e zgjedhjeve ku ka pasur raporte për parregullësi.

26. Në Raportin e saj Përfundimtar mbi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008, OSBE/ODIHR-ja rekomandoi që mospërputhshmëritë midis Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për kundërvajtje të zgjidhen në mënyrë që KSHZ-ja të mund të fillojë procedurat kundër personave të cilët kryejnë kundërvajtje zgjedhore të shkruara në Kod. Kjo çështje duket se është adresuar në **Nenin 31(3)**. E njejta dispozitë gjithashtu ia imponon KSHZ-së për detyrë t'i largojë anëtarët e një organi menaxhues të zgjedhjeve në rast të aktiviteteve të paligjshme. Megjithatë, ky Nen nuk e përcakton procedurën për këtë, ndërsa Kodi do të përfitonte me përshkrimin e qartë të procedurës.

27. **Neni 35(2)** thotë se KSHZ-ja “përcakton me një akt procedurat për emërimin e Kryetarit të KKZ-së, zëvendësin, anëtarët, dhe zëvendësuesit e tyre,” dhe në **Nenin 39(3)** e njejta aplikohet për KZ-të. Të dy nenet e lënë të papërcaktuar çështjen nëse emërimet janë një standard ose një akt *ad hoc*. Procedurat për këto emërimet do të përfitonin nga një elaborim i mëtëjshëm, veçanërisht për shkak se rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-së propozuan që kryetarët dhe zëvendësit e këtyre organeve të zgjedhen – nga radhët e anëtarëve të zgjedhur në mënyrë të rastësishme – ose nga vetë organi (me votim të brendshëm) ose nga organi tjetër zgjedhor i nivelit më të lartë (KKZ-ja, respektivisht KSHZ-ja).⁹

28. **Neni 37(2)** i cili flet për kompetencat e KKZ-ve dhe të Komisionit zgjedhor për Qytetin e Shkupit mbetet i paqartë edhe përkaj ndryshimeve të fundit dhe do të ketë nevojë për qartësim të mëtëjshëm.

29. Më saktësisht, **Neni 37(2), paragrafi 2** u jep KKZ-ve kompetencën “*për të shkarkuar anëtarët e Këshillit zgjedhor [...] në ditën e zgjedhjeve.*” Neni nuk e përcakton as procedurën me të cilën KKZ-ja mund të shkarkojë anëtarë të KZ-së, as nëse pushteti për shkarkim zbatohet edhe para ditës së zgjedhjeve.

30. Përveç kësaj, **Neni 37(2), paragrafi 10** thotë që KKZ-ja “Regjistron përfaqësuesit e autorizuar për mbikqyrjen e punës për zgjedhjet lokale.” Megjithatë, Kodi duhet ta qartësojë nëse partitë dhe kandidatët e kanë patjetër t’ia dorzojnë KKZ-ve listën e përfaqësuesve të tyre të autorizuar, dhe nëse është kështu cili është afati përfundimtar dhe çfarë sanksionesh zbatohen në rast të dështimit për të dorzuar një listë të tillë.

31. Përfundimisht, **Neni 37(2), paragrafi 16** i Kodit me të cilin KKZ-ja obligohet të “*vendosë në bazë të ankesave*” duket se është në kundërshtim me **Nenin 148(1)** i cili ia jep KSHZ-së kompetencën për të vendosur për ankesat.

32. **Neni 38** i referohet përbërjes së KZ-së. Mënyra në të cilën është shkruar neni, mund të çojë në keqkuptim, për shembull: “Këshilli zgjedhor duhet të përbëhet nga një Kryetar, katër anëtarë dhe zëvendës të tyre ...”. Teksti duket se nënkupton që KZ-ja është e përbërë nga 9 anëtar, ndërsa në fakt janë 5. Numri i saktë duhet të jetë patjetër i qartë për qëllime të vendimmarrjes. Mund të këshillohet që të saktësojë në rend të parë numrin e përgjithshëm të anëtarëve të cilët e përbëjnë KZ-në, e pastaj të elaborohet funksionet e secilit përfshi edhe raportet, si dhe ndonjë dallim midis, nëse ka, anëtarëve dhe zëvendësve.

⁹ Shih rekomandimin numër 9 të Misionit të OSBE/ODIHR-së për vëzhgimin e zgjedhjeve në Raportin përfundimtarë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 1 qershor 2008, faqe 26.

E. Lista e votuesve

33. Prej 1 shtator 2009, përgjegjësia mbi listën e votuesve do t'i jepet KSHZ-së, ndryshim ky nga Kodi i mëprashëm i cili ia kishte dhënë këtë përgjegjësi Ministrisë së Drejtësisë. Kalimi i kësaj përgjegjësie tek një organ i cili përbëhet edhe nga anëtarë të qeverisë, edhe nga opozita duhet të rrisë besimin te ky proces.

34. **Neni 43** përcakton obligimin e Minsitrisë së punëve të brendshme për të dorëzuar të dhëna për listën e votuesve. Teksti aktual nuk tregon qartë se të dhënat duhet të dorëzohen edhe për personat të cilët nuk kanë mbushur 18 vjet në kohën e dorëzimit të të dhënave, por të cilët do të jenë të kësaj moshe në ditën e zgjedhjeve.

35. **Neni 46** parashikon përgatitjen e fragmente të posaçme të listës së votuesve për mbajtjen e zgjedhjeve në kazerma ushtarake, ndërsa **Neni 47** qartëson se stafi ushtarak voton në njesinë/komunën ku është vendosur njësi ushtarak ose kazerma. E njëjta mund të përfundohet nga **Neni 113**. Kodi i praktikave të mira në çështjet zgjedhore këshillon që ai staf duhet të votojë në vendin ku kanë regjistruar vendbanimin e tyre të përhershëm sa herë që është e mundshme.¹⁰ Edhe pse kjo është e vështirë dhe mbase e pamundur për t'i mundësuar gjithë stafit ushtarak të votojë në vendbanimin e tyre, votimi në vendvotimet e tyre vendore duhet t'i mundësohet asaj pjese të stafit ushtarak ose njesisë e cila mund të jetë vendosur në komunën e tyre amë.

36. **Neni 55(1)** parasheh mbrojtjen e të dhënave personale që gjenden në listën e votuesve, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave. Më tej thotë që të dhënat "*nuk duhet të përdoren për ndonjë qëllim tjetër veç atij të ushtrimit të së drejtës për të votuar nga ana e qytatarëve.*" Megjithatë, paragrafi vijues (**Neni 55(2)**) kërkon nga KSHZ-ja t'i furnizojë me të dhëna – të gjitha të dhënat – nga lista e votuesve cilëndo parti të regjistruar politike ose kandidat të pavarur me kërkesë të tyre. Standardet e Këshillit të Evropës dhe OSBE-së¹¹ parashohin që korniza ligjore të theksojë qartë përdorimin e lejueshëm të informacionit të marrë nga lista e votuesve dhe nëse ky informacion mund të përdoret për qëllime të ndryshme nga kontestimi i regjistrimit të një votuesi të posaçëm. Në veçanti, ligji duhet të theksojë nëse informacioni mund të përdoret për aktivitete të fushatës së partive politike dhe të kandidatëve. Korniza ligjore duhet gjithashtu të theksojë sanksionet për keqpërdorimin e informacionit të marrë nga regjistrat e votuesve.

Ë. Definimi i njesive zgjedhore për zgjedhjet parlamentare

37. Në bazë të Kodit, gjashtë njësitë për zgjedhje parlamentare nuk duhet të kenë dallim mbi 5% të numrit mesatar të votuesve dhe secila njësi zgjedh 20 deputetë në Parlament. Përderisa nuk ka standarde për metodën e definimit të njesive, një klauzolë e tillë krijon nevojën për rerefinim të rregullt të njesive me ndryshimin e numrit të popullsisë. Për shkak se procesi i rerefinimit të njesive ka pasoja të konsiderueshme politike, mund të merren parasysht edhe qasje të tjera të mundshme.¹² Është e zakonshme të rregullohen njësitë zgjedhore dhe t'i shpërndajnë mandatet në mënyrë proporcionale me numrin e votuesve (dmth. një mandat për çdo 20 000 votues). Nëse një mënyrë e tillë e përdorimit të njesive zgjedhore fikse me numra ndryshues të mandateve do të ishte miratuar, rregulli i përgjithshëm për shpërndarjen e mandateve sipas njesive do të nevojitej të përfshihet në Kodin zgjedhor.

¹⁰ Shih Kodin e praktikave të mira në çështjet zgjedhore, I. 3.2. xii

¹¹ Shih *inter alia* Udhëzimet për të shqyrtuar kornizën ligjore për zgjedhjet, p. 14.

¹² Shih Kodin e praktikave të mira të Komisionit të Venedikut, pjesa I. 2.2, 17.

F. Listat e kandidatëve

38. Kalimi i detyrave për mbikqyrjen dhe mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetje nga ana e zyrave lokale të Ministrisë së drejtësisë tek KSHZ-ja është një zhvillim i mirëseardhur i cili duhet të veprojë për të zvogëluar çfarëdo presioni mbi nënshkruesit për të mbështetur partitë qeverisëse. **Neni 63(2)** i Kodit duhet të qartësojë procedurën për mbledhjen e nënshkrimeve gjatë procesit të regjistrimit të kandidatit në zyrat lokale, para së gjithash KKZ-të (meqenëse vetë KSHZ-ja nuk është e përfaqësuar në nivel lokal).

a. Përkatësia etnike

39. **Neni 64(3)** thekson se secili kandidat për parlament duhet të përfshijë “*deklaratën për përkatësinë etnike të tij/saj*”. Ky kriter është vendosur për të mundësuar shtypjen e fletëvotimeve në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik, si dhe në gjuhën e bashkësisë përkatëse etnike. Në bazë të Kodit të praktikave të mira në çështjet e zgjedhjeve¹³ dhe të Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare¹⁴, askush nuk duhet të detyrohet të deklarohet se i përket një pakice kombëtare. Një deklaram i tillë duhet të jetë një e drejtë dhe jo detyrim. Prandaj duhet të merret parasysh heqja e deklaramit të detyrueshëm për përkatësinë etnike nga neni 64(3) dhe zëvendësimi i tij mundësisht me shkrimin e emrit të kandidatit, të shtypur në listë, në gjuhën origjinale.

b. Gjinia

40. Dispozitat mbi përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve mbeten midis “avangardës” në Evropë. **Neni 64(5)** thekson se në listat për këshillat parlamentare dhe lokale duhet të ketë “të paktën një vend nga tre të rezervohet për gjininë më pak të përfaqësuar.” Një Opinion i Perbashkët i mëhershëm¹⁵ nxori në pah se ky tekst mund të ketë një efekt anësor të padëshiruar dhe se një formulim më i mirë do të dukej kështu:

“Duhet të ketë së paku një kandidat të secilës gjini në mesin e tre kandidatëve të parë në listë, dy nga secila gjini në mesin e gjashtë të parëve në listë, tre nga të dyja gjinitë në mesin e nëntë të parëve, etj”

c. Profesioni

41. Në bazë të **Nenit 63** lista e kandidatëve domosdo duhet të përmbajë, në mes tjerash, informata për profesionin e kandidatëve. Në përputhshmëri me rekomandimet e përsëritura disa herë nga Opinionet e Përbashkëta të mëparshme, duhet të konsiderohet nëse janë të nevojshme asi lloj informatash dhe nëse mungesa e profesionit ose pavërtetësia e dispozitës konsiderohet “parregullësi”. Kjo do t’i mohonte një kandidati të drejtën për të marrë pozitë.

G. Fushata

a. Rekomandimet e mëparshme

42. Në Raportin përfundimtar mbi zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008, ODIHR-ja rekomandoi

¹³ Shih Kodin e praktikave të mira në çështjet e zgjedhjeve, I. 2.4 c.

¹⁴ Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Strasburg, 1.II.1995, Neni 5, par. 2.

¹⁵ Shih Opinionin e pwrbashkwt mbi Kodin Zgjedhor tw “ish republikws Jugosllave tw Maqedonisw” (CDL-AD(2006) 022), faqe 31, paragrafi 103.

që **Neni 73** i Kodit zgjedhor - i cili parasheh që shkeljet gjatë periudhës së fushatës të procesohen në Gjykatat themelore – të elaborohet për të përcaktuar lëndën e ankesës¹⁶, të pandehurit potencialë, forma(t) e veprimit (civile, të kundërvajtjes dhe/ose penale), si dhe zgjidhje të mundshme.

43. Procedura e fushatës nuk rregullohet në mënyrë eksprese për rrethet e dyta të zgjedhjeve – ato për Kryetar të Republikës dhe për kryetarë komune. **Neni 74(1)**, thotë se fushata duhet të mbarojë “24 orë para ditës së zgjedhjeve”. Duhet të kuptohet se këto dispozita zbatohen gjatë rrethit të dytë, por preferohet që të bëhet e qartë.

44. Në Opinionin e Përbashkët të vitit 2007, në paragrafin 27,¹⁷ Komisioni i Venedikut dhe OSBE/ODIHR-ja vërejtën se në **Nenin 181(2)** është shtuar një paragraf i ri i cili imponon një gjobë të lartë për ata të cilët nuk “respektojnë kornizën kohore për fillimin dhe përfundimin e fushatës zgjedhore”. Definicioni i “fushatës zgjedhore” është shumë i gjërë: “prezantimi publik i kandidatëve, i konfirmuar nga organet e autorizuar menaxhuese të zgjedhjeve, dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore të proceseve përkatëse zgjedhore”. Aktivitetet e rregullta politike duket se bien nën afatin kohor dhe duket e paarsyeshme të jenë subjekt i gjobës nëse një parti bën “prezantime publike” të kandidatëve të tyre para fillimit të fushatës 20 ditore. Kodi zgjedhor duhet ta bëjë të qartë saktësisht se cili aktivitet politik është i lejueshëm dhe cili jo para fillimit të periudhës për fushatën zyrtare. Rekomandohet që rregullat për fushatë të hershme të aplikohen vetëm për rregullativa të veçanta të mediave, Siç është koha e transmetimit falas, shpërndarja e hapsirës falas e përcaktuar qartë për vendosjen e materialeve të fushatës dhe për ndarjen e fondeve shtetërore.

45. **Neni 187** parasheh që një parti politike të gjobitet prej 3 000 deri më 5 000 euro për:

- mosparaqitjen e tubimit zgjedhor të paktën 48 orë para mbajtjes së tij; dhe
- organizimin e tubimeve në kundërshtim me **Nenin 81 dhe 82** të këtij Kodi.

46. **Neni 81** kërkon që organizatori i fushatës ta informojë me shkrim degën adekuate të Ministrisë së punëve të brendshme, 48 orë përpara, sa herë që organizatori do të mbajë “tubim para-zgjedhor në vende publike dhe në vende të transportit publik ...” **Neni 82** i përkufizon vendet ku mund të mbahen ose të mos mbahen tubime të tilla.

47. Është e paqartë nëse një parti dhe/ose organizator duhet të gjobitet nëse ata nuk e informojnë Ministrinë e punëve të brendshme për një tubim i cili nuk do të mbahet në një “vend publik” ose në “vend publik transporti” (dmth rrugë, etj.). Për të shmangur gjobën, **Neni 187** parasheh që çdo tubim pa marrë parasysh vendin se ku do të mbahet, duhet patjetër të paraqitet në Ministrinë e punëve të brendshme; ndërsa **Nenet 81 dhe 82** parashohin që vetëm ato tubime të cilët mbahen në vende “publike” të kërkojnë një praktikë të tillë. Neni 187 duket tepër restriktiv, meqenëse ka pak arsye të vlefshme për të dënuar një person ose subjekt në rast se nuk e informojnë Ministrinë e punëve të brendshme për tubimet të cilat nuk do të pengonin vendet publike ose komunikacionin.

b. Mbulimi mediatik i fushatës

48. Kodi ka pësuar shumë përmirësime në drejtim të mbulimit mediatik dhe monitorimit.

¹⁶ Përfshirë edhe mundësinë e së drejtës së një dorëzuesi të listës së kandidatëve të ankohet për veprime të bëra nga dorëzues të listave tjera të kandidatëve.

¹⁷ *Shih* Opinionin e përbashkët të draft tekstit punues për ndryshim të Kodit zgjedhor të “ish republikës Jugosllave të Maqedonisë” (CDL-AD(2007)012), faqe 6, paragrafi 27.

Miratimi i Rregullores për menaxhimin kohor, të tarifave dhe qasjes së barabartë në mediat transmetuese është veçanërisht i mirëseardhur. Megjithatë, akoma nuk ekzistojnë kërkesa eksplicite për mbulim korrekt dhe të barabartë të garuesve në lajme dhe në programet për çështjet aktuale të mediave elektronike. Duhet të ketë kërkesa më precize mbi mbulimin e atyre që janë në pushtet.

49. **Neni 74(2)** i Kodit zgjedhor i jep Këshillit për radiodifuzion mandatin për të monitoruar mbulimin e zgjedhjeve nga mediat jo vetëm gjatë periudhës së fushatës zyrtare, por edhe nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fund të votimit në ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, kompetencat e Këshillit për radiodifuzion për të rregulluar mediat gjatë periudhës para fushatës nuk janë të qarta në Ligjin për aktivitetet radiodifuzive. Ligjet do të përfitonin nga harmonizimi në këtë pikë. Ligjet mund të harmonizohen edhe rreth çështjes së shumës së paguar për reklamim nga transmetuesit privatë. Kodi zgjedhor kufizon shumën e reklamës së paguar politike për të cilat mediat kanë leje të transmetojnë deri në 15 minuta për orë; Ligji për aktivitete radiodifuzive lejon maksimumin e 12 minutave.

c. Financimi i fushatës

50. Dispozitat për financimin e fushatës në **Nenet 83-87** janë qartësuar dhe përforcuar në përputhje me rekomandimet e mëhershme, megjithatë brengosjet mbeten. Dispozitat mbi financimin e fushatës duhet të forcohen për të siguruar mbikqyrjen e mirëfilltë të rregullave të financimit dhe të vendosin kufinj efektiv mbi donacionet dhe harxhimet, si dhe të qartësojnë procedurat e raportimit dhe të revizionit.

51. **Nenet 83 dhe 84** të Kodit zgjedhor duhet të rishikohen me qëllim të heqjes së përjashtimeve për kufinj të donacioneve për fushatën të cilat duket se e dobësojnë qëllimin e ligjit. Për shembull, **Neni 83(2)** lejon që fushatat të financohen “nga taksat e anëtarësisë në partitë politike”, por nuk është dhënë asnjë limit. Në mënyrë që të mos u shmangen kufinjve të donacionit Kodi duhet të ndalojë tejkalimin e shumave të lejuara të këtyre taksave të anëtarësisë në kontribues individual ose kompanish në të njëjtin paragraf, dmth 5 000 respektivisht 20 000 euro.

52. Procedura e revizionit duhet të përforcohet për të siguruar mbikqyrjen e financave të të gjithë kandidatëve të cilët marrin pjesë në zgjedhje. Përveç kësaj, nuk ka kërkesë në Kod për një raport të përkohshëm financiar nga ana e organizatorit të fushatës, përkaj rekomandimeve të mëhershme në këtë drejtim.

53. **Neni 83** nuk lejon harxhim të fondit të përgjithshëm të partive politike për fushatën. Prandaj, donacionet për fushatën duket se janë lejuar vetëm pas hapjes së llogarisë rrjedhëse. Donacionet për partitë politike të cilat kanë ndodhur para fillimit të fushatës nuk mund të përdoren për fushatën. Këto dispozita janë tejet restriktive. Me mekanizma adekuat të kontrollit për financimin e partive politike do të ishte e mundur për të lejuar harxhime nga donacionet për partitë të cilat bëhen para fillimit të fushatës, ose që partive t’u lejohet depozitimi i donacioneve të pranuar më parë dhe fondeve të paharxhuara nga fushatat e mëparshme në llogarinë rrjedhëse.

54. **Neni 83(1)** ndalon financimin e fushatës zgjedhore nga fonde të ndërmarrjeve të përbashkëta ku kapitali i huaj është dominant. Mund të qartësohet nëse nocioni i kapitalit të huaj nënkupton edhe kapitalin e investuar në këto ndërmarrje të përbashkëta nga ana e subjekteve ligjore të regjistruara në vend, por të cilat janë pronë e personave ose subjekteve ligjore të huaja.

55. Rregullorja e financimit nuk lejon harxhimin para dorëzimit të listës së kandidatëve. Do të ishte e vështirë të organizohet përpilimi i një liste kandidatësh, mbledhja e nënshkrimeve ose planifikimi i stilit ose strategjisë për fushatën pa harxhime. Duhet të merret parasysh lejimi i harxhimeve gjatë një periudhe të arsyeshme para datës së dorëzimit të listës (për shembull një deri në dy javë), ose mbase edhe përjashtimin e disa harxhimeve “përgatitore” nga kontrolli i mundësuar nga Kodi.

56. **Neni 86** i Kodit i cili mundëson kompensimin e harxhimeve të fushatës (vetëm) për kandidatët e zgjedhur, duhet të merret sërish parasysh dhe mundësisht të zëvendësohet me një sistem sipas të cilit të gjithë kandidatët që fitojnë një përqindje të caktuar të votave, ose marrin së paku një mandat të kenë të drejtë për kompensim. Një përqindje e tillë duhet të jetë mjaftë e lartë për të dekurajuar kandidatët joserioz, por mjaft i ulët për të siguruar më shumë motiv për gratë dhe anëtarët e komuniteteve më të vogla etnike, të cilët nganjëherë përballen me vështirësi në grumbullimin e fondeve të nevojshme për të bërë një fushatë të fortë.

57. **Neni 86(3)** parasheh që kompensimi i harxhimeve zgjedhore “të përcaktohet me vendim” të Parlamentit, të keshillit komunal dhe të Qytetit të Shkupit. Njekohësisht, **Neni 86(1)** parasheh të drejtën e kompensimit në raste dhe shuma konkrete. Duket të jetë kontradiktore – ose të paktën e panevojshme – të kërkohet një vendim për diçka që është tashmë e paraparë me ligj. Poashtu, ndryshimet mund të bëhen për të qartësuar nëse kompensimi duhet të llogaritet në bazë të rrethit të parë ose të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune.

58. Procedura dhe kushtet e pagesës dhe mohimi i kompensimit për kandidatët, në bazë të **Nenit 87** të Kodit duhet të bëhet në mënyrë më të hollësishme. Kodi Zgjedhor (ose rregulloret) duhet të përcaktojë përmbajtjen dhe formatin e raporteve financiare që duhet të dorëzohen nga garuesit; në vecanti, forma aktuale e përshkruar nga Ministria e Financave duhet të ndryshohet meqenëse nuk i obigon garuesit të dorëzojnë të dhëna për harxhimet, gjë që e dëmton transparencën dhe dobinë e një raportimi të tillë.

Gj. Mbjajtja e votimit

59. **Neni 89** parasheh që KZ-të të marrin numrin e njejtë të fletvotimeve sa që ka votues në regjistër. Në rast se ka dalje të votuesve prej 100%, nuk do të kishtë fletëvotime të mjaftueshme që do t’u mundësonte votuesve zëvendësim të fletëvotimit. Prandaj, ky sistem nuk e merr parasysh që votuesit mund të bëjnë gabim dhe të kërkojnë korrigjim, meqë nuk ka asnjë fletëvotim shtesë në dispozicion. Mund të parashihet një fleksibilitet që do të mundësonte një përqindje të fletëvotimeve shtesë për çdo KZ.

60. **Neni 101(3)** thotë: “Këshilli zgjedhor mund ta mbyllë vendvotimin para kohës që është paraparë në paragrafin 1 të këtij Neni, në rast se gjithë votuesit e regjistruar në regjistrin e listës së votuesve kanë hedhur votën e tyre.” Formulimi i këtij neni mund të bëjë ndonjë këshill zgjedhor të nënkuptojë se ata mund të mbyllin votimin dhe t’i numërojnë votat para kohës zyrtare për mbyllje (7 pas dite). Nëse ndodh kështu, numërimi i hershëm mund të humbë mundësinë e vëzhguesve që të jenë prezent gjatë numërimit, meqë ata nuk do të dinin paraprakisht se kur do të behej ai. Rekomandohet që neni të përcaktojë atë se lejohet vetëm mbyllje, por jo edhe numërim në rastin e mëlart përmendur.

61. **Neni 106** i referohet detyrimit që zyrtarët dhe vëzhguesit në vendvotim të mos kenë shenja ose simbole të asnjë partie politike ose kandidatëve gjatë kohës që janë në vendvotim.

Megjithatë, neni nuk e përmend mbajtjen e bexhave ose identifikimi tjetër që do ta lehtësonte njohjen e stafit të autorizuar në vendvotim. Duke marrë parasyshë numrin e lartë e njerëzve të joautorizuar të cilët janë vërejtur në vendvotime gjatë zgjedhjeve të kaluara, këshillohet që njerëzve të autorizuar t'u kërkohet të mbajnë bexha gjatë kohës që janë në detyrë në vendvotim.

H. Procedura e numërimit

62. **Neni 114** përcakton procedurën e numërimit. Opinionet e Përbashkëta të mëhershme rekomanduan që procesi të ndryshohet, në mënyrë që numri i përgjithshëm i fletëvotimeve, numri i fletëvotimeve të papërdorura dhe numri i votuesve që kanë votuar në bazë të nënshkrimeve ose gjurmëve të gishtit në listën e votuesve të shkruhen në formularë përpara se të hapen kutitë e votimit. Kjo do të zvogëlonte mundësinë për manipulim në shkallë të mëtejshme gjatë procesit të numërimit.

63. **Neni 116** përcakton numrat që duhet të shënohen në formularët e vendvotimit. Megjithatë, nuk ekziston kusht që KZ-ja të bëjë pajtueshmëri të numrave, për shembull, të rinumërojë në rast se numri i fletëvotimeve në kuti nuk pajtohet me numrin e votuesve që kanë votuar në bazë të listës së votuesve. Në shumë shtete ekzistojnë rregulla të veçanta për raste ku numri i fletëvotimeve në kuti e tejkalon numrin e votave, bazuar në listën e votuesve (mbushje e kutive), ose nëse numri është më i vogël se sa numri i atyre që kanë votuar bazuar në listën e votuesve (vjedhje e fletëvotimeve).

64. **Neni 119** kërkon që KKZ-ja t'i mbledhë rezultatet e votimit nga zgjedhjet presidenciale, por nuk e përcakton qartë se cilat numra duhet të shënohen në formularë. Formatit për zgjedhjet lokale është dhënë në **Nenin 131** kurse për zgjedhje nacionale formati i formularëve të KSHZ-së është dhënë në **Nenin 128**, por do të ishte në dobi nëse formati jepet edhe për raportet e KKZ-së (edhe pse këto numra, në zgjedhjet nacionale, nuk do të ishin finale).

65. **Neni 126(5)** thotë që, "Vëzhguesit vendorë të autorizuar duhet të marrin kopje të protokoleve për përllogaritje," por nuk përmend nëse vëzhguesve ndërkombëtarë gjithashtu u jepet e drejta për këtë informatë. E njëjta e drejtë duhet t'u jepet edhe atyre.

66. As **Nenet 127 dhe 128**, por as **Neni 31(2)** mbi detyrat e KSHZ-së nuk vendos detyrim të qartë mbi të për shqyrtim aktiv të rezultateve nga komisionet dhe këshillat nënrenditëse me qëllim që të hetojë anomalitë në formularë dhe t'i korrigjojë gabimet. Vetëm gabimet e raportuara do të hetohen. Gjithsesi nuk është e mundur të vërtetohen të gjitha aspektet e punës së organeve më të ulta, posaçërisht kur ka një listë të madhe të detyrave, KSHZ-ja duhet të nxisë shqyrtim përpara se rezultatet të finalizohen, e të cilat janë të dukshme edhe pse nuk janë të raportuara. Ligji duhet të jetë i qartë se KSHZ-ja është e autorizuar që gjithashtu të hetojë raste të tilla. E njëjta vlen edhe për KKZ-të dhe obligimet e tyre gjatë zgjedhjeve lokale.

67. **Neni 135** e obligon KSHZ-në të shpallë rezultatet e KKZ-së ashtu siç janë pranuar. Kjo e përforcon transparencën e votimit. Paragrafi (2) thotë, megjithatë, se rezultatet do të publikohen brenda 24 orëve nga koha kur janë bërë finale. Është rëndë të kuptohet shkaku pse rezultatet finale nuk duhet të publikohen menjëherë. Duhet të merret parasyshë ndryshimi i **Nenit 135(2)** në këtë drejtim.

68. Rekomandohet që ligji të përfshijë një detyrim për KSHZ-në (dhe KKZ-në për zgjedhjet lokale) që të publikohen përllogaritjet e plota të rezultateve nga niveli i vendvotimit në nivel rajonal ose nacional. Vetëm me anë të kësaj, vëzhguesit dhe publiku i gjërë mund të shohin se

rezultatet e vendvotimit të tyre u janë shtuar në mënyrë të drejtë rezultateve të përgjithshme.

I. Anulimi i rezultateve

69. **Neni 151(1)** parasheh në hollësi situatat në të cilat rezultatet e zgjedhjeve duhet të anulohen. Dispozitat e qarta në këtë çështje shmangin çdo lloj paqartësie dhe mundësojnë parashikim më të mirë. Mëgjithatë, mund të dalin situata të cilat janë të paparashikueshme në Kodin Zgjedhor. KSHZ-ja duhet të ketë së paku pak diskrecion në anulimin e rezultateve poashtu edhe në situata të tjera, nëse kanë ndodhur keqpërdorime dhe parregullësi në procesin zgjedhor (p.sh. fushata zgjedhore ose gabime në listën e votuesve).

J. Procedura e ankesës

70. Vendim-marrja për ankesat në Gjykatën Administrative është rregulluar vetëm në mënyrë të përgjithshme, ndërsa në disa vende bie ndesh me Ligjin e përgjithshëm të procedurës administrative. Meqenëse rezultatet duhet domosdo të dalin shpejt, ky proces ka nevojë për një rregullore më të detajuar në mënyrë që të shmangen mosmarrëveshjet.

71. Vendim-marrja në Gjykatën Administrative për çështjen e ankesave është e kufizuar me aftin prej 48 orësh në bazë të **Neneve 67(7), 141(3), 150(2) dhe 151(5)**. Ky është njëri nga afatet më të shkurtëra që japin procedurat në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Është poashtu e vështirë për gjykatësit t'i shqyrtojnë dëshmitë dhe të dalin me bazë ligjore për një vendim të tillë në këtë afat kohor, veçanërisht për shkakun se gjykata duhet të vendosë për ankesat në mënyrë kolektive. Sygjerohet që afati kohor brenda të cilit gjykatat duhet të vendosin për ankesat të zgjatet, por patjetër të mbetet mjaft i shkurtër për të mundësuar zgjidhje efikase gjatë zgjedhjeve. I njejtë rekomandim aplikohet edhe për procedurën e ankesave dhe apeleve të organeve tjera ligjore, të dhëna në **Nenin 73(2) dhe (4)**. Më tej, nëse afatet zgjaten, e në mënyrë që të garantohet efikasiteti i procedurës së ankimimit, gjykata duhet të pajiset me të drejtën për t'i mbledhur dëshmitë vetë.

72. Në bazë të **Neneve 67(8), 141(4) dhe 147(4)** parashtrimi, përmes postës, i një ankese ose apeli për mbrojtjen e së drejtës për votim nuk është i lejuar. Rekomandohet që në rast se ankesa është parashtruar me postë, të mos llogaritet për zgjedhjet aktuale, por të pranohet si “jo-urgjente” dhe të zgjidhet më vonë, për zgjedhjet e ardhshme. Përndryshe, personi i cili dërgon një ankesë duhet patjetër ta zgjidhë problemin përsëri, para zgjedhjeve të ardhshme.

73. Për votimin jashtë shtetit, në Zyrat Diplomate Konsullare, procedurat e ankimimit dhe apelimit, për shembull “për të mbrojtur të drejtën e votës” (**Nenet 50-51**), për parashtruesit e listave (**Neni 67**) dhe për organizatorët e fushatës (**Neni 73**) duket se nuk janë adresuar fare. Me afatet e shkurtëra aktuale dhe për faktin që parashtrimi i ankesës përmes postës nuk është i lejuar, votuesi jashtë shtetit, parashtruesi i listës ose organizatori i fushatës do të kenë vështirësi të mëdha për të përfituar nga mbrojtja e gjykatës.

74. Për sa i përket procesit të ankimimit dhe apeleve, edhe Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet në bazë të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-së për zgjedhjet presidenciale dhe lokale të vitit 2009, për të mundësuar si vijon:

1. Një afat për KSHZ-në që të propozojë zyrtarisht anulimin e zgjedhjeve;
2. Bërjen të qartë nëse ankesat mund të parashtrohen përmes faksit;

3. Rrethanat specifike sipas të cilave KSHZ-ja obligohet të kontrollojë materialin zgjedhor kur shqyrtohen ankesat. Nëse qëllimi i ligjit është që materialet zgjedhore të kontrollohen vetëm në rast të ndonjë kundërshtimi të regjistruar në procesverbalin e rezultateve të KZ-ë ose KKZ-së, kjo çështje atëherë duhet theksuar qartë; dhe
4. Një deklaram të qartë për atë se kush ka të drejtë të parashtrojë aktpadi kundër vendimeve dhe afateve përkatëse të KSHZ-së.

K. Zgjedhjet e parakohshme

75. Në bazë të **nenit 158(2)**, zgjedhjet e parakohshme nuk duhet të shpallen në rast se deri në zgjedhjet e rregullta kanë ngelur më pak se gjashtë muaj. Në mënyrë që të shmanget mbajtja e postit të zbrazët për aq gjatë, mund të sygjerohet zgjedhja e kryetarit të komunës pa vonesë dhe t'i zgjatet mandati i postit që zgjedhjet e ardhshme të mbahen në të njëjtën kohë me zgjedhjet e rregullta lokale.

L. Konkluzione

76. Ndonëse ndryshimet e tetorit 2008 i forcuan disa aspekte të Kodit Zgjedhor të “ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, Kodi do të përfitonte nga përmirësimet e mëtejshme mbi bazën e Opinioneve aktual dhe të Opinioneve të Përbashkëta të mëhershme të Komisionit të Venedikut dhe OSBE-ODIHR-së.

77. Në mesin e rekomandimeve, OSBE/ODIHR-ja dhe Komisioni i Venedikut do të rekomandonte fuqishëm implementimin e këtyre:

- Heqjen e kërkesës e përqindjes së nevojshme të daljes së votuesve në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale;
- Rishikimin e procedurave të emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, në veçanti të Komisioneve Komunale Zgjedhore;
- Rishikimin e sistemit për votimin jashtë shtetit;
- Rishikimin e metodës së definimit të njësive, në veçanti të skicimit të njësive zgjedhore;
- Rishikimin e dispozitave për mbulimin mediatik dhe më saktësisht të atyre që kanë të bëjnë me reklamimin e paguar;
- Adresimin e shqetësimeve në lidhje me financimin e fushatës;
- Përmirësimin e procesit të numërimit; dhe
- Përmirësimin e procesit të ankesave dhe apeleve me anë të miratimit të dispozitave më të hollësishme.

78. Me të ndryhuar, Kodi Zgjedhor duhet të përfaqësojë bazë të përmirësuar për procesin zgjedhor, përfshi edhe periudhat para dhe pas zgjedhjeve. Megjithatë, implementimi korrekt i legjislativës zgjedhore kërkon gjithashtu edhe vullnetin politik të të gjithë faktorëve.